



**ANALIZA STATISTIKORE PËR NUMRIN E TURISTËVE
DHE BUJTJEVE TË REALIZUARA
PËR PERIUHDHËN KOHORE JANAR-DHJETOR 2012**

Бр./Nr. _____

20
СТРУГА / STRUGË

ПЛОШТАД "МАЈКА ТЕРЕЗА" Б.Б.
SHESI "NËNË TEREZA" P.N.
6330 СТРУГА / STRUGË

ТЕЛ. / TEL. 046 781 – 335
781 – 223
782 – 015

ФАКС / FAKS 046 781 – 434

Е-ПОШТА: / E-MAIL:
kryetari@struga.gov.mk
info@struga.gov.mk

Turizmi paraqet shumë e raporteve dhe dukurive që dalin nga udhëtimi dhe qënrimi i turistëve në një vend, ku udhëtimi dhe qëndrimi i tillë nuk do të bazohet në banim të përhershëm dhe nëse me to nuk është e lidhur kryerja e ndonjë veprimtarie ekonomike. *Turist* paraqet çdo person, i cili për shkaqe pushimi, rekreimi, shëndetësie, familiare dhe religjioze, debate dhe tubime publike realizon të paktën një bujtje jashta vendit të banimit të përhershëm në një objekt hotelierik apo objekt tjetër për akomodim të turistëve. *Turizmi* ndërkombëtar paraqet shumë të raporteve dhe dukurive që rezultojnë në momentin kur turisti kalon kufirin shtetëror dhe qëndron në vendin tjetër më së paku një natë për shkaqe pushimi, rekreimi apo ngjashëm.

Turisti paraqet çdo person, i cili qëndron përkohësisht në një vend jashta vendit të banimit të përhershëm dhe atje kalon më së paku një natë në objekt hotelierik ose në ndonjë objekt tjetër akomodues. *Turist vendas* paraqet person me vendbanim të përhershëm në Republikën e Maqedonisë, i cili qëndron përkohësisht në vend tjetër jashta vendbanimit të përhershëm dhe kalon më së paku një natë në objekt hotelierik ose në ndonjë objekt tjetër akomodues për turistët. *Turist i huaj* paraqet person me vendbanim të përhershëm jashta Republikës së Maqedonisë, i cili qëndron përkohësisht në Republikën e Maqedonisë dhe kalon më së paku një natë në objekt hotelierik ose në objekt tjetër akomodues për turistët¹.

Në bazë të të dhënave statistikore², numri i turistëve në vitin 2012 në Komunën e Strugës ka qenë gjithsej **55556** turistë, prej të cilëve **32451** janë turistë vendas, kurse numri i turistëve të huaj ka qenë **23105** turistë. Në vitin 2012 janë realizuar gjithsej **295728** bujtje, prej të cilave **208207** nga ana e turistëve vendas, kurse turistët e huaj kanë realizuar gjithsej **87519** bujtje.

Tabela nr.1, Numri i turistëve dhe bujtjeve të realizuara në Komunën e Strugës për vitin 2012

Numri i turistëve dhe bujtjeve të realizuara	Turistë			Bujtje të realizuara		
	Gjithsej	Vendas	Të huaj	Gjithsej	Vendas	Të huaj
Gjithsej	55556	32451	23105	295728	208207	87519

Burimi: Enti Shtetëror Statistikor, Shkup, 2012

Sipas numrit të turistëve të huaj që kanë qëndruar në Strugë në vitin 2012, vendin e parë e kanë zënë turistët nga Mbretëria e Holandës me **6290** turistë, në vend të dytë Turqia me **4567** turistë, kurse në vend të tretë Republika e Greqisë me **2250** turistë. Nga gjithsej **23105** turistë të huaj, **13107** turistë (gjegjësisht **56.72%**) bëjnë pjesë nga shtetet e


¹ Definicionet për turistin, turistin e vendit dhe turistin e huaj janë dhënë në bazë të shpjegimeve metodologjike që jep Enti Shtetëror Statistikor i Republikës së Maqedonisë me seli në Shkup (për informacione më të hollësishme kliko në uebfaqen e këtij enti: www.stat.gov.mk).

² Enti Shtetëror Statistikor i Republikës së Maqedonisë, *Të dhëna statistikore për Komunën e Strugës*, Shkup, 2012, faqe 1.



lartëpërmendura. Sipas numrit të bujtjeve të realizuara, nga gjithsej **87519** bujtje, në vend të parë ka qenë Mbretëria e Holandës me **45459** bujtje, në vend të dytë Republika e Turqisë me **7118** bujtje, kurse në vend të tretë Republika e Greqisë me **5319** bujtje të realizuara. Shtetet që përmenden më lartë marrin pjesë me **66.15%** në numrin e përgjithshëm të bujtjeve të realizuara.

Numri i turistëve për vitin 2012



Numri i bujtjeve të realizuara për vitin 2012

